



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:096265

Datë: 10.01.2025

Numri i dokumentit: 06778292

**2023:113440**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.B., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm PP/II.nr.521/23, të datës 19.05.2023, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor publik më datë 18.12.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Sadat Topalli, të dëmtuarit E.P., të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij me autorizim av. Elvira Heta Vata, me dt.19.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 10.01.2025 përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari B.B., nga i ati S., e ëma M., e vajzërisë Sh., i lindur më ....., në fsh. ...K. ....ku dhe tani jeton, me numër personal ....., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin e mjekësisë, me profesion internist, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë veprë penale, ndaj tij, nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse me e datën 22.03.2023, rreth orës 20:30 në ....., saktësisht në objektin ....., me dashje dhe me qëllim të frikësimit ose shkaktimit të ankthit e ka kanosur seriozisht personin zyrtar-mjekun E.P., se do ti shkaktojë ndonjë të keqe, i cili ishte duke kryer detyrën zyrtare, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje lidhur me punën, me një pacient që ishte ardhur për tu trajtuar në këtë qendër, i pandehuri kishte telefonuar të dëmtuarin, ku fillimisht e fyer e pastaj e kanos me fjalët “ a pe kryen këtë rast a po vij aty dhe po të bëjë llom dhe ta kallxoj qefin”, me ç’ rast të dëmtuarit i kishte shkaktuar shqetësim, frikë dhe pa siguri.

Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 44, 69, 70 dhe 181 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 364, 452, 460 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të akuzuarin e :

## **G J Y K O N**

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim në gjobë në shumën prej 400 € (katërqind euro), dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t’i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo njëzet euro (20 €) do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € /njëzetë Euro/, si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 /njëzet/ Euro, të gjitha brenda afatit prej 30 ditëve.

I dëmtuari E. I. P. nga . rr.”....”, ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/II.nr.521/23, e datës 19.05.2023, ka ngarkuar të akuzuarin, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar për të akuzuarin gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas akuzës, me datë 18.12.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit, i dëmtuari, i akuzuari dhe mbrojtësja e tij me autorizim.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të akuzuarin për të drejtat e tija në kuptim të nenin 319 par.1 dhe 2 të KPPRK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata dhe më tej shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës dhe para leximit të saj prokurori i shtetit ka deklaruar se bëj rikualifikimin e dispozitivit të aktakuzës saktësisht në rendin e pestë të këtij dispozitivi të hiqet fjalë e hap derën me forcë, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar. Gjyqtari pasi që është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, konform nenit 321 paragrafi 1 të KPPRK-së, i ka afuar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën më ngarkon aktakuza e prokurorit të shtetit Kanosja nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK, jam i njoftuar me pasoja t e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen time, dua të shtoj e rasti ka ndodh krejt rastësisht gjatë kohës sa kemi qenë duke punuar së bashku me të dëmtuarin në emergjencën e qytetit të Ferizajt, i kërkoj falje publike dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin.

Pasi që i akuzuari deklaroi se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, gjyqtari në kuptim të nenit 322 par 2 të KPPRK-së, morri mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale Kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par. 1 të KPPRK-së, pasi që një pranim i tillë është bërë në mënyrë vullnetare duke o kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim është bërë në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPPRK-së, në mbështetje të provave dhe fakteve që i përmban kjo aktakuzë, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtën të aprovoj.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, po ashtu nuk paraqes ndonjë kërkesë pasurore juridike dhe mund të theksoj edhe unë se rasti ka ndodh atëçastshëm pa ndonjë paramendim nga i pandehuri.

Mbrojtësja e të akuzuarit lidhur me pranimin e fajësisë së akuzuarit deklaroi se e mbështes pranimin e fajësisë nga i akuzuari –i mbrojturi im dhe i propozoj gjykatës që të pranoj këtë pranim fajësie dhe të njëjtin ta merr veçanërisht lehtësuese gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë, Raporti i Oficerit i datës 22.03.2023, Deklarata e dëmtuarit të dhënë në polici me datë 22.03.2023, Deklarata e të pandehurit të dhënë në polici me datë 22.03.2023.

Pasi që Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në përputhje me kërkesat nga neni 242 par. 2 KPPRK-së, konform nenit 322 paragrafi 4 të KPPRK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

## Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor i akuzuari e pranoi veprën penale për të cilën akuzohet dhe i mbështetur në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që gjatë shqiptimit të sanksionit penale të ketë për bazë rrethanat lehtësuese dhe rënduese të paraparë në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethanë rënduese të merret shkalla e lartë e dashjes e paraparë në nenin 70 par.2 pika 2.2, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merren pranimi i fajit, nga neni 70 par. 3 pika 3.10, shprehja e keqardhjes e paraparë në pikën 3.11 si dhe kërkim falja. Andaj i propozoj gjykatës që të shqiptoj një sanksion penale të paraparë me ligj.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar e mbështes në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit, siç deklarova edhe më herët nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale, po ashtu nuk paraqes ndonjë kërkesë pasurore juridike ndaj të pandehurit dhe më tepër nuk kam çka të shtoj.

Mbrojtësja e të akuzuarit në fjalën përfundimtare deklaroi se sot Besimi para jush në këtë shqyrtim gjyqësor pranoi se pa dashje pra në moment të atëçastshëm për shkak të vlugut të madh të punës është shprehur me tonë më të ashpër ndaj tani të dëmtuarit, por kjo ka ndodhur për shkak të numrit të madh të pacientëve dhe për shkak të profesionalizimit të madh që ka ky njeri si doktor në raport me pacientët edhe para se të deklarohet para jush Besimi është munduar që të kërkoj falje drejtpërdrejt të dëmtuarit qoftë përmes miqve të përbashkët kolegëve e po ashtu edhe përmes një komunikimi me sms ku para se të ngritët aktakuza i ka kërkuar falje të dëmtuarit dr. Emrushit. Prandaj kërkojmë nga ju që gjatë matjes së dënimit të keni parasysh shkallën e ulët të dashjes, se i njëjti momentum ka ndodhur në mënyrë të atëçastshme pa pasur ndonjë paramendim të mëhershëm, etika e tij e lartë e punës nën betim të hipokratit për dhënien e ndihmës mjekësore pacienteve dhe ndoshta toni i tij i lartë që është shprehur në drejtim të kolegut të tij me fjalë kërcënuese siç ceket në aktakuzë pa pasur ndonjë qëllim për shkakimin e ndonjë të keqe reale tani të dëmtuarit Emrush. Pra të gjitha këto rrethanë kërkoj nga gjykata që të ketë parasysh gjithashtu se i njëjti asnjëherë nuk ka ra ndesh me ligjin, është hera e parë e tij që hapet një procedurë kundër tij, ka kërkuar falje publikisht dhe ka shprehur pendim të thellë në drejtim të veprës penale dhe në drejtim të dëmtuarit. Në qoftëse gjykata po të shpall një dënim për të njëjtin atëherë në bazë të nenit 70 dhe 71 kërkoj që të aplikohet zbutja nën minimumin e paraparë ligjor ose dënimi i shqiptuar të zëvendësohet me dënim gjobë, gjithashtu duke pasur parasysh se

i njëjti është mbajtes i familjes, është i vetmi person që punon në familje që gjoha që i shqiptohet të mos e rrezikoj ekzistencën e gjithë familjes.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi, e përkrahi në tërësi atë që tha mbrojtësja ime –avokatja tani në fjalën e saj përfundimtare dhe mbetem në tërësi në atë që e thash më lartë.

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimin e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe i akuzuari u shpallë fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari e ka bërë pranimin e fajësisë, pendimin e tij dhe kërkim faljen publike që i ka bërë të dëmtuarit, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërit vepra të tilla apo të ngjashme, se nuk ka dëshmi nga evidenca e gjykatës se i njëjti para kryerjes së kësaj vepre penale të ketë qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, ndërsa rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë dhe se për herë të parë ka kryer vepër penale do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, e në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërisë dhe autorit të tij, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale (preventiva gjenerale)

Vendimi për kërkesën pasurore- juridike, është marr konform nenit 460 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ,  
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL  
2023:113440, datë 10.01.2025**

Bashkëpunëtori profesional  
Shkelzen Polloviqi

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Imri Sejda

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.